

Data 02.08.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Rikonstruktion i shkollës "Muhamet Hasmuja", Ktosh”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime ndërtimi për shkolla 45214200-2

VLERA E FONDIT LIMIT:

55 292 325 (pesëdhjetë e pesë milion e dyqind e nëntëdhjetë e dy mijë e treqind e njëzete pesë)lekë pa TVSH dhe 66 350 790 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e treqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë) lekë me tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Malesi e Madheka hartuarprocesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Sipas Shtojces 7.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të tre viteve të fundit (2020- 2021 - 2022) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore , të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivitetit . Shenim: Ne respektim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëqë dy bilanci të njepasnjeshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur në zbatim të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", etj.

2.2.2. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020- 2021 - 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontrates që po prokurohet. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e informacionit te paraqitur ne zbatim te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u bazuar ne Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

2.2.3 OE pjesemarrës duhet te paraqese vertetim per shlyerjene detyrimeve vendore per vitet 2022 dhe 2023.

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbyshur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 76, pika 2, e LPP, si dhe nenin 26 pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1.Për të provuar përvojën e mëparshmeofertuesi duhet të dorezojë:

1- Punë të ngjashme, për 1 (një) kontratë të vetme në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vleres limit te objektit qe prokurohet, të realizuar gjatë pese viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Ose

2- Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vleres se fondit limit te objektit që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa vlera e fondit limit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Mbeshtetur në rëndesinë e objektit të prokurimit, vlerën e fondit limit të venë në dispozicion, tipologjinë e punimeve të ndërtimit etj.

2.3.2. Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të Kontrates.

Ofertuesi duhet të disponojë licencë profesionale sipas modelit të leshuar nga Ministria përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, e vlefshme me kategorite:

Kategoria NP-1 A-“Punime germimi”

Kategoria NP-2 A-“Ndërtime civile dhe industriale”

Kategoria NP-3 B-“Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada”

Kategoria NS-1 A- “Punime për prishjen e ndërtimeve”

Kategoria NS-2 A- “Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre”

Kategoria NS-4 A - “Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.”

Kategoria NS-8 A -“Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri”

Kategoria NS-12 A-“Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit”

Kategoria NS-14 A -“Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj”

Kategoria NS-19 A-“Sistemet kundër zhurmës për infrastrukturë”

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

- **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe të ligjit nr. 10081,

datë 23.2.2009, "Përlicencat, autorizimetdhelejetnëRepublikën e Shqipërisë", tëndryshuar, dhetënenit 18, tëligjit nr.8402, datë 10.9.1998, "Përkontrollindhedisiplinimin e punimevetëndërtimit", tëndryshuarsiedheVendimin nr. 42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteretdheprocedurat e dhenies se licencaveprofesionaletezbatimit, klasifikimitdhedisiplinimittesubjektevejuridike, qeushtrrojneveprimtarindertimi", pikat e licencesdhekatgorite me klasifikimetperkatesecaktohen duke u mbeshetur ne punimet e parashikuara ne preventivin e objektitdhenevlerentotalatepunimeve per secilenkatgori.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente .

Kategoritë e kërkuara janëkërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve sipas preventivit bashkengjitur DST dhe konkretisht:

| Nr. | Kategoria e lic. | Zerat ne preventiv |
|-----|------------------|---|
| 1 | Kategoria NP-1 | Seksioni II- "Punime dheu" Zeri nr.1 |
| 2 | Kategoria NP-2 | Sipas llojit te objektit- Ndertesa Civile, industrial... |
| 3 | Kategoria NP-3 | Sipas llojit te objektit, rikonstrukcion ndertesash civile |
| 4 | Kategoria NS-1 | Seksioni I- "Punime ndertimi" Zeri nr.2 |
| 5 | Kategoria NS-2 | Seksioni II- "Punime hidroasanitare" |
| 6 | Kategoria NS-4 | Seksioni I- "Punime Suvatimi" |
| 7 | Kategoria NS-8 | Seksioni B- "Shkalla emergjence" Seksioni B- "Punime per terren sportiv" |
| 8 | Kategoria NS-12 | Seksioni F- "Punime per ngrohjen" |
| 9 | Kategoria NS-14 | Seksioni B- "Punime Elektrike" |
| 10 | Kategoria NS-19 | Seksioni II- "Punime dyer dritare" |

2.3.3 Ofertuesi duhet te jete i pajisur me Certifikate:

ISO 9001:2015 - Certifikate per sistemimin e menaxhimit te Cilesise;

ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit)

ISO 45001:2018 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)

Certifikatat duhet te jene ne gjuhen e ofertes, ne perputhje me natyren e objektit qe tenderohen dhe te jene lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në emër të ofertuesit.

Ne rast bashkimi operatoresh, keto certifikata duhet ti kete secili operator ekonomik ne baze te perqindjes se punimeve qe merr perisiper ne akt-marreveshje.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79,pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.4 Ofertuesi duhet te kete një punësim mesatar jo me pak se 45 (dyzet e pese) punonjes (numer i nevojshem dhe i mjaftueshem per kryerjen e punimeve ne kohe, sipas analizes, bazuar ne preventivin dhe grafikun e punimeve) , per periudhen Prill 2023 – Qershor 2023. Kjo do te vertetohet me:

-Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj per periudhen perkatese;

-Listë pagesat e punonjesve për periudhën perkatese te konfirmuar nga Administrata Tatimore (ne forme elektronike);

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualitekniktecimimevetepunimevetendertimitdheteanalizavetekniketetyre “(perllogaritja e orevetePunessiedhetemjetevetenevojshme) , KodiiPunes ne RSH , siedhebazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt te objektit dhe konkretisht rezultojne 18 punetore te thjeshte numer i cili duke u mbledhur me drejtuesit teknik dhe personelin mbeshtetes sipas pikes 2.3.5, 2.3.5/1 dhe2.3.6 japin numrin 45.

2.3.5 Ofertuesi duhet te kete drejtues teknik ne licencen e zbatimit te punimeve, te pakten:

- a. 1 (nje) Ing. Ndertimi
- b. 1 (nje) Ing. Mekanik
- c. 1 (nje) Ing. Elektrik
- d. 1 (nje) Ing. Hidroteknik

Per drejtuesit teknik si me lart, ofertuesi duhet te paraqese kontratat e punes, diplomat dhe CV.

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

Argumentimi:Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Inxhinieret e kerkuar ne piken 2.3.5 jane ne perputhje me licencat e kerkuar ne piken 2.3.2.

- a. 1 (nje) Ing. Ndertimi (Ne preventiv parashikohen punime germimi, punime rikonstruksioni ndertesh)
- c. 1 (nje) Ing. Mekanik (Ne preventiv parashikohen punime per impjant ngrohje)
- d. 1 (nje) Ing. Hidroteknik (Ne preventiv parashikohen punime per sisteme hidrosanitare)
- e. 1 (nje) Ing. Elektrik (Ne preventiv parashikohen punime per rikonstruksion te rrjetit elektrik te nderteses).

2.3.5/1 Ofertuesi duhet te disponoje staf mbeshtetes 1 (nje) Arkitekt dhe te figuroje ne listepagesat e shoqerise per periudhen Prill 2023 – Qershor 2023.

Per kete, ofertuesi duhet te paraqese kontraten e punes, diplomen dhe CV.

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.6. OE ofertuesi duhet te kete te perfshire ne stafin e tij, te certifikuar nga një organ i akredituar çertifikues personeli (Trup Certifikues), si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë me profesionet e poshteshenuara, minimumi per periudhen Prill 2023 – Qershor 2023, jo me pak se:

- a. Teknik ndertimi 1 (nje)
- b. Karpentier 2 (dy)
- c. Saldator 2 (dy)

- d. Marangoz 2 (dy)
- e. Murator 4 (kater)
- f. Pllakashtrues 2 (dy)
- g. Bojaxhi 3 (tre)
- h. Punetor izolimi (hidroizolues) 2 (dy)
- i. Suvatues 2 (dy)
- j. Specialist gipsi 1 (nje)
- k. Punetor Duro-alumini 1 (nje)
- l. Hidraulik 2 (dy)

Per keta te paraqiten kontratat e punes , cv dhe dokumenti certifikues i siperperkerkuar.

Per punonjesin teknik ndertimi duhet te paraqitet kontratat e punes , cv, dokumenti certifikues i siperperkerkuar dhe dokumenti qe verteton kualifikimin (deftese dhe/ose diplome).

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar punonjesit e mesiperm, me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

| | | |
|----|---------------------------------------|--|
| 1 | Teknik ndertimi 1 (nje) | (Per te kontrolluar punen ndertimore dhe per te dhene udhezime te ndryshme per punimet). |
| 2 | Karpentier 2 (dy) | Per punimet e armaturave |
| 3 | Saldator 2 (dy) | Seksioni "Shkalle emergjence" Zeri nr.2 dhe 3 Seksioni "punime rrethimi" Zeri nr.6 |
| 4 | Marangoz 2 (dy) | Seksioni "Punime sistemim i jashtem" Zeri nr.9 Seksioni "Punime catie" Seksioni "Punime hidroizolimi" – zeri nr.1 Seksioni "5.Punime dyer dritare"- zeri nr.2 |
| 5 | Murator 4 (kater) | Seksioni "punime rrethimi" Seksioni "punime betoni dhe b/a" Seksioni "punime murature" |
| 6 | Pllakashtrues 2 (dy) | Seksioni "5.Punime shtresa" – zeri nr.4 Seksioni "3.Punime shtresa dhe veshje" – zeri nr.1 |
| 7 | Bojaxhi 3 (tre) | Seksioni "6.Punime bojatisje" Seksioni "9.Punime bojatisje" |
| 8 | Punetor izolimi (hidroizolues) 2 (dy) | Seksioni "2.Punime h/izolimi dhe catie" Seksioni "8.Punime hidroizolimi" |
| 9 | Suvatues 2 (dy) | Seksioni "6. Punime suvatimi dhe veshje" Seksioni "4.Punime suvatimi" |
| 10 | Specialist gipsi 1 (nje) | Seksioni "Punime suvatimi dhe veshje" – "Tavan me katonxhes" |
| 11 | Punetor Duro-alumini 1 (nje) | Seksioni "5.Punime dyer dritare" Seksioni "7.Punime dyer dritare" |
| 12 | Hidraulik (dy) | Seksioni "10.Punime hidrosanitare" Seksioni "E.Punime Hidrosanitare" |

2.3.7. OE ofertuesi duhet te kete te perfshire ne stafin e tij, te certifikuar nga një organ i akredituar çertifikues personeli (Trup Certifikues), jo me pak se:

- a. Manovratore 2 (dy)
- b. Shofer 3 (tre)

Per keta te paraqiten kontratat e punes , cv dhe dokumenti certifikues i siperperkerkuar.

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

Argumentimi:Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar punonjesis e mesiperm, me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.

- a. Manovratore 2 (dy)- per drejtimin e mjeteve: Eskavator, autovinc, fadrome sipas rendit te puneve.
- b. Shofer 3 (tre) – per drejtimin e mjeteve kamion , kamioncina, autobot etj, sipas rendit te puneve.

2.3.8 Dëshmi për makinerite dhe paisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion ofertuesit, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, si me poshte (ne pronesi ose me qira):

| Nr. | Mjetet | Sasia | Gjendja | Pershtatshmeria me preventivin (Justifikimi) |
|-----|------------------|--------|------------------------|---|
| 1 | Eskavator | 1 cope | Në pronësi ose me qera | Seksioni ”1.Punime dheu” Zeri nr.1 |
| 2 | Autovinc me kosh | 1 cope | Në pronësi ose me qera | Seksioni ” 2.Punime h/izolimi dhe catie” Zeri |

| | | | | |
|----|-----------------------------------|---------------------|------------------------|---|
| | | | | nr.2 dhe 3. |
| 3 | Kamion me veteshkarkim min. 5 ton | 2 cope | Në pronësi ose me qera | Seksioni ” 1. Punime te ndryshme dhe prishje” Zeri nr. 8. Seksioni ”1. Punime dheu”- zeri nr.2. Seksioni ” 2. Punime rrethim” Zeri nr. 2 dhe 8. |
| 4 | Kamioncine | 2 cope | Në pronësi ose me qera | Seksioni ” 1. Punime te ndryshme dhe prishje” Zeri nr.2 |
| 5 | Autovinc | 1 cope | Në pronësi ose me qera | Seksioni ” 4.Punime hekuri” Seksioni ”7. Shkalle emergjence” |
| 6 | Fadrome | 1 cope | Në pronësi ose me qera | Seksioni ”H. Punime Sistemim i Jashtme” Zeri nr.6 |
| 7 | Autobetoniere | 1 cope | Në pronësi ose me qera | Seksioni ” 2.Punime betoni dhe b/a” Zeri nr.5 |
| 8 | Karroca dore | 8 cope | Në pronësi ose me qera | Per perdorim brenda kantierit te ndertimit |
| 9 | Kokore | 45 cope | Në pronësi ose me qera | Per sigurine ne pune te punetoreve |
| 10 | Jelek per veshje | 45 cope | Në pronësi ose me qera | Per sigurine ne pune te punetoreve |
| 11 | Tabela sinjalizuese | 4 cope | Në pronësi ose me qera | Per te evidentuar punimet |
| 12 | Saldartrice | 2 cope | Në pronësi ose me qera | Seksioni ”Shkalle emergjence” Zeri nr.2 dhe 3 Seksioni ”punime rrethimi” Zeri nr.6 |
| 13 | Skela | 2000 m ² | Në pronësi ose me qera | Per rrethimin e objektit dhe sigurimin e kushteve teknike te nevojshme ne kantier. |
| 14 | Armatura | 300 m ² | Në pronësi ose me qera | Seksioni ” 2.Punime betoni dhe b/a’- zeri nr.5 |

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fitesit dhe fillimit te afateve te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: Leje qakullimi, siguracion, kolaudim, taksa, Certificate/licence transporti si dhe kontraten perkatese të qerave dhe licencen e transportit për të tretet (nese eshte me qera), e vlefshme për të gjithë periudhen e realizimit të kontrates objekt i këtij prokurimi. (Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fatura tatimore perkatese fotot, ndersa per mjete te marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperme, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te punimeve deri ne perfundimin e plote te punimeve. (Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

b) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij. (Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart)

c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës deklaron se drejtuesit teknik të përfshirë në licencën e zbatimit të punimeve, të shoqërisë së tij nuk janë të punësuar në asnjë institucion shtetëror.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Mjetet dhe pajisjet e mesiperme janë kërkuar duke u bazuar në zerat perkates te preventivit, sipas tabelës së mesiperme.

2.3.12 Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jete i pajisur me licence nga QKL me kod III.2.B me emertimin e veprimtarise “Grumbullim dhe transportim i mbetjeve inerte”;

Argumentim: Kërkesat e sipërcituara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77, pika 2 ku citohet se: *“Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë”*, si dhe në zbatim të nenit 39, pika 6/a/b të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose”. Ndërsa përcaktimi i llojit të licencave nga ofertuesi, referuar natyrës së kontratës, bazohet në ligjin 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në VKM-në nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

2.3.10. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jete i pranishëm në objekt gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet si dhe një deklaratë nga vete drejtuesi teknik që është dakord me angazhimin në mënyrë të vazhdueshme për nevojat e institucionit.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 39, (pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të dy kritereve të sipërcituara lidhur me stafin inxhinierik dhe drejtuesin teknik të punimeve, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës dhe mban përgjegjësi teknike dhe drejtuese për zbatimin e kontratës në mënyrë cilësore. Për këtë qëllim, referuar edhe vlerës së kontratës për ndërtimin e ujësjellësit, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që drejtuesi teknik të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Por në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, AK ka qartësuar se ky detyrim duhet të përmbushet vetëm kur plotësohen kushtet ligjore. Pra në rastin e bashkimit të subjekteve, drejtuesi teknik duhet të jetë i angazhuar gjatë gjithë kohës, vetëm nëse vlera e preventivuar e punimeve e marrë përsipër nga anëtarë i bashkimit është mbi 30,000,000 (tridhjetë milionë) lekë, në zbatim të Udhëzimit Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”. Gjithashtu kontraktori duhet të deklarojë se drejtuesi teknik i përfshirë në liçencën e shoqërisë nuk duhet të jetë i angazhuar në

asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publik, në zbatim të Kreut IV, pika 2 të VKM-së Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

2.3.11. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të paraqesin nje kontrate noteriale furnizimi(ose qiraje) me inerte dhe rere.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.9 Operatori/et ekonomike ofertues duhet të kene nje marreveshje te konkretizuar me nje venddepozitimi (subjekt te licencuar dhe te njohur nga nga organet ligjore) brenda territorit administrative te qarkut shkoder, te mbetjeve te ndryshme ndertimore qe dalin gjate punimeve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që zoterojne anen teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, sic eshte mundesia per depozitimin e mbetjeve inerte qe dalin nga kantieri i punimeve dhe qe sipas ligjit Nr.10 463, datë 22.9.2011 për menaxhimin e integruar të mbetjeve“ ky venddepozitim duhet te jete brenda territorit administrativ ne nivel qarku qe mbulon vendin e kantierit te ndertimit .

2.3.13. Operatori/et ekonomike ofertues duhet të paraqese analizat teknike per te gjithë zerat e preventivit qe jane me “AN”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin prova te zberthimit te rregullt te preventivit dhe qe e bazojne oferten e tyre mbi bazen e nje analize te sakte te shpenzimeve dhe fitimeve per punen objekt kontrate.

Disa nga zerat e preventivit nuk parashikohen ne manualin e cmimeve dhe analizave teknike keshtuqe operoret duhet te deshmojne menyren se si i ofertojne keto zera .

2.3.14. Ofertuesi duhet te paraqese grafikun e punimeve te firmosur dhe vulosur nga administratori.

Grafiku i punimeve në përputhje me zërat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit, kjo në respektim të VKM nr.285, date 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”..